



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.67/2019
Prishtinë, më 11.6.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Lutfi Zharku, Glauk Konjufca, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Liburn Aliu dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

I ftuar: **Bajram Zejnullahu**, kryesues i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit-AKP.

Pjesëmarrës të tjerë: Valon Tolaj, drejtor menaxhues i AKP-së, Adem Selishta, Armend Hamza, Labinot Smajlaj – AKP; Blerta Bejtullahu – EU/Office; Ardiana Tusha – KDI; Semra Çitaku – Ambasada Britanike; Shpëtim Haziri – GP LDK; Vatra Qehaja – LVV; Marigona Bajrami – PSD dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, si dhe praktikanti Afrim Berisha.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.6.2019;**
3. **Votimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2018;**
4. **Diskutim lidhur me kërkesën e KOSTT-it;**
5. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2018;**
6. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 06.6.2019

Procesverbali, i mbledhjes së datës 06.6.2019, u miratua pa vërejte.

3. Votimi i Raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK për vitin 2018

Kryetarja theksoi se mbledhjen e fundit më 6.6.2019, u pajtuam që mos ta votojmë këtë raport, në mënyrë që të shohim shkresat që i ka dërgua AKK lidhur më çështjen e homologimit. Por pas kërkesës nga koordinatori i komisionit, siç e keni parë, kryesuesi i Bordit të AKK-së, nuk e ka dëshmuar që të njëjtat ia ka dërguar komisionit. Në ato shkresa shihet që është njoftuar kryetari i Kuvendit për Agjendën në Reformën Evropiane dhe një Mendim Profesional që ia ka dërguar Ministrisë së Infrastrukturës, e jo rekomandim siç pretendonin.

Muharrem Nitaj potencoi se përfaqësuesit e AKK-së gjatë prezantimit të raportit nuk na kanë bindur lidhur me punën e tyre, si dhe nuk mundën që përfaqësues të një mekanizmi kaç të rëndësishëm me ardhur me informacione gjysmë të vërteta apo edhe të pasakta para komisionit.

Glauk Konjufca theksoi se i shoh të ndara raportin me temën për të cilën po flasim tash. Raporti mund të jetë i varfër apo me mangësi, por çështja për të cilën po flasim, kjo absolutisht është prej njollave të zeza në procesin e Kosovës edhe të përmbushjes së MSA-së edhe obligimeve në drejtim të integritetit evropian. Autoriteti i Konkurrencës tashmë e ka bërë të ditur se çfarë gabimi ka qenë ky i Qeverisë për vazhdimin e marrëveshjes për homologim që përbën monopol i cili me ligjet e Bashkimit Evropian është i papranueshëm. Propozoj ta mbajmë një seancë punë në këtë komision që ka të bëjë pikërisht me këtë çështje, edhe t'i thërrasim autoritetet e rëndësishme vendore, edhe të Bashkimit Evropian që janë në Kosovë.

Kryetarja tha se sa i përket homologimit pajtohem që të mbajmë seanca dëgjimore ku mund t'i ftojme edhe përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, edhe ministrin, dhe të shohim qëndrimet e këtyre institucioneve. Nga Zyra e BE-së në Kosovë kemi marrë një shkresë ku jemi njoftuar me komunikimin që e ka pasur Zyra e BE-së me Ministrinë e Infrastrukturës, edhe mund t'i ftojme të shohim mendimin e tyre për çështjen e homologimit.

Muharrem Nitaj tha se pasi që për shkak të procedurave raporti duhet të shkojë në seancë, atëherë unë jam që raporti të dërgohet në seancë pa mbështetjen e komisionit.

Pas diskutimeve, komisioni, me 1 (një) votë “për”, 4 (katër) “kundër”, dhe 1 (një) “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

Nuk miratohet Raporti vjetor i punës për vitin 2018 i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës – AKK.

4. Diskutim lidhur me kërkesën e KOSTT-it

Kryetarja në mbledhjen e fundit më 6.6.2019, u njoftuam nga menaxhmenti i NP KOSTT-it, lidhur me sfidat që paraqet miratimi i Ligjit për pagat, andaj, në këtë fazë ne, si komision, s'mund të marrim ndonjë veprim, mirëpo, mund të nxjerrim një "Përfundim", që në rast të ndryshim plotësimit të Ligjit për pagat, në do të përkrahim kërkesat e KOSTT-it.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Nëse procedohen në shqyrtim ndryshimet legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për paga, komisioni mbështet kërkesat e NP KOSTT.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së për vitin 2018

Kryetarja theksoi se sot e kemi në shqyrtim raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2018. Për të prezantuar raportin kryetarja ia kaloi fjalën kryesuesit të bordit të AKP-së, z. Bajram Zejnullahu.

Bajram Zejnullahu, kryesues i Bordit të AKP-së, duke prezantuar raportin theksoi se Agjencia ka arritur të implementojë strategjinë nëpërmjet të cilave ka përmbushur objektivat të cilat ndikojnë në përmirësimin e imazhit dhe rritjen e efikasitetit të procesit të privatizimit. Agjencia ka avancuar në përmbushjen e objektivave të realizimit të planit të shitjes së aseteve. Në kohën kur bordi është bërë funksional, bordi ka filluar me ndarjen e mjeteve për kreditorët e ndërmarrjeve shoqërore, si dhe ndarjen 20%-shit të punëtorëve të ndërmarrjeve. Agjencia po ashtu ka avancuar në transformimin e pronës së shitjes me negociim direkt. Në vitin 2018 Agjencia ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi në mes të AKP-së, MTI-së dhe Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, për pjesëmarrje të përbashkët në promovimin e ndërmarrjeve dhe aseteve shoqërore në formë të projekteve për investime strategjike. Ndër vendimet më të rëndësishme që agjencia ka marrë janë transferimi i fondeve të mbetura në shumën prej 42 milionë dhe prej fondeve të përbashkëta në shumën mbi 43 milionë në fondin e Republikës së Kosovës. Ne jemi të përkushtuar të vazhdojmë angazhimin maksimal, në përmbushjen e objektivave strategjike dhe mbylljen e suksesshme të mandatit të Agjencisë. ky proces është i lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin e një ekonomie, bashkëkohore të tregut përmes transformimit.

Valon Tolaj, drejtor menaxhues i AKP-së, duke arsyetuar raportin paraqiti punët operative të AKP-se, ku potencoi se të hyrat totale të Agjencisë për periudhën prej fillimit të privatizimit kap shifrën prej 800 milionë euro, prej të cilave 23 milionë euro janë vetëm për vitin 2018. Agjencia ka perfomuar mirë, duke marrë parasysh faktin që deri në gjysmën e vitit 2018 agjencia ka qenë pa bord. Në momentin që është votuar bordi në parlament, pastaj ka vazhduar me dinamikën e shitjeve. Sidoqoftë vetëm gjysma e dytë e vitit 2018 nuk ka mjaftuar që të arrihet efekti maksimal i të hyrave financiare. Në tabela janë të paraqitura saktësisht të hyrat financiare, të hyrat nga shitja rreth 18 milionë euro, të hyra nga qiraja janë rreth 6 milionë euro dhe të hyra të tjera, si dhe rreth 7 milionë euro transfere të 20%-shit të punëtorëve. Një çështje

tjetër që ja vlen të theksohet është se gjatë vitit 2018 i janë transferuar 36 milionë euro buxhetit të shtetit konform ligjit për buxhet, ndërsa, për vitin 2019 kjo shumë është më e madhe.

Kryetarja, duke iu referuar raportit vjetor të AKP-së, i parashtroi disa pyetje për përfaqësuesit e AKP-së, si vijon: A mund ta sqaroni pse është aplikuar forma e shitjes së aseteve përmes likuidimit, dhe çfarë forma tjera të privatizimit janë aplikuar? A ka ndërmarrje tjera që janë me spin off special, apo vetëm një, si dhe edhe sa do të zgjasë monitorimi i ndërmarrjes me spin off-i special? Çfarë e ka karakterizuar privatizimin me spin off special dhe me spin off me kushte të veçanta? A mund ta konsideroni si formë të suksesshme të privatizimit, apo jo? A mund ta shpjegoni çështjen e pagesës shtesë, dhe sa është vlera e pagesës shtesë në raport me vlerën e përgjithshme të shitjes së Sharr Cem-it? Ku qëndron problemi me ndërmarrjet nën administrim direkt, sidomos me ato që janë në Gjakovë? Kostoja e shpenzimeve për këto ndërmarrje a i ngarkohet AKP-së apo i ngarkohet këtyre ndërmarrjeve në formë krediti nga Qeveria? Si dhe kur pritet që këto ndërmarrje të hiqen nga administrimi direkt? Kërkojmë ta sqaroni më shumë pse iu është shlyer ndëshkimi ndërmarrjes “IDGJ Tobacco”? Në çfarë faze gjendet procesi i inkasimit të ndëshkimeve për ndërmarrjet që iu janë marrë aksionet sikurse “Grand Hotel” Prishtinë, “MIM” Golesh dhe “XIM” Strezoc. Sa është numri i kërkesave kreditore të aprovuara nga Bordi, dhe sa kërkesa janë refuzuar? A mund ta sqaroni më saktë se ku ka arritur deri më tani procesi i tranzicionit të Trepçës, dhe cila është përgjegjësia e AKP-së në këtë proces? Cila është gjendja e aseteve jashtë Kosovës, dhe çka do të bëhet me ato? A mund ta shpjegoni si po zhvillohet procesi i identifikimit të aseteve të reja, dhe çfarë mendoni se duhet bërë në mënyrë që të identifikohen të gjitha asetet që mund të ekzistojnë, e jo të vazhdojnë të mbesin të paignifikuar edhe më tej? Korniza ligjore ekzistuese, a paraqet pengesa në zbatim të detyrimeve ligjore të AKP-së dhe a mendoni se korniza ligjore ka nevojë për ndryshime?

Lutfi Zharku pyeti se pse AKP nuk do të ketë buxhet të mjaftueshëm për vitin 2020 e tutje? Kur i jepni asetet me qira, pse nuk kërkonin garanci bankare nga qiramarrësi, sepse duhet të ekzistojë një mënyrë që askush nuk do të mund t’i ikë mos pagesës së qerasë? Lidhur me borxhet e Qeverisë, pse kur ja keni transferuar buxhetit të Kosovës mjetet nga privatizimi, nuk ia keni ndalur pjesën sa ka borxh Qeveria? Keni thënë se 20% të ofertave janë anuluar gjatë shitjes, cilat janë arsytet e anulimit të shitjeve? Të sqarohet çështja e Fabrikës së Baterive në Pejë? Te “MIM Goleshi” u përmend një plan biznesi financiar nga GIZ-i, ta sqaroni çfarë programi ka GIZ për zhvillimin e “MIM Goleshi”? Pse nuk bëhet rishpallja e Grand Hotelit për shitje? Si mendoni me i inkasuar 31 milionë euro ndëshkime?

Glauk Konjufca pyeti përfaqësuesit e AKP-së se a keni ndonjë koncept strategji se deri kur duhet me vazhduar puna e AKP-së? Pse nuk ka listë të aseteve të shfrytëzuara pa kontrata? Sa asete janë ende të uzurpuara, a janë vetëm në veri apo edhe në pjesën tjetër të Kosovës, si dhe a bashkëpunoni me Qeverinë për me i liruar këto asete? Ta sqaroni situatën për operimin e AKP-së në veri dhe problemet që janë atje? A keni të drejtë që një pjesë të hyrave nga privatizimi t’i investoni në Kosovë, dhe a keni plan që t’i investoni në Kosovë?

Valon Tolaj, AKP, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve tha se shumica e ndërmarrjeve iu janë nënshtruar likuidimit sepse janë jo profitabile. Aktualisht AKP është e koncentruar të privatizojë asetet përmes likuidimit? Për një pjesë të ndërmarrjeve jemi në pritje të Qeverisë që privatizimi të bëhet përmes ligjit për investime strategjike, siç janë ndërmarrjet Grand Hotel,

Ballkan Suharekë, MIM Goleshi, XIM Strezoci, Tokat bujqësore, etj. Shitjet përmes spin off-it special janë bërë shumë herët dhe këto ndërmarrje është dashur të monitorohen për një periudhë të caktuar, të gjitha kontrata janë mbyllur përveç njëres që ende është në monitorim. Lidhur me Sharr Cem-in, AKP e ka ndëshkuar blerësin për mos përmbushje të zotimeve për investime, mirëpo blerësi është ankuar në Arbitrazh dhe jemi në pritje të vendimit të Arbitrazhit. Ndërmarrjet në Gjakovë janë në një situatë të dhimbshme. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka vendosë masë të përkohshme të ndalimit të privatizimit për këto ndërmarrje derisa të sqarohet pronësia e aksioneve. Këto objekte mund të jepen vetëm me qira, dhe privatizimi i tyre varet nga vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Trajtimi i rreth 91 mijë kërkesave kreditore është punë e madhe. Nuk e dimë saktë numrin e kërkesave të refuzuara sepse një pjesë e madhe e tyre kanë bërë ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Armend Hamza, AKP, sqaroi se IDGJ Tobacco është privatizuar më 2007 përmes metodës së spin off-it special. Zakonisht këto kontrata i kanë pasur dy kushte: investimet dhe punësimin. Deri më 2012 kur janë bërë raportet e auditimit, kjo ndërmarrje ka rezultuar se ka përmbushur pjesën më të madhe të kushteve kontraktuale. Më 2012 është bërë kontrata e novacionit, me të cilën është përtërirë kjo kontratë, dhe se bordi i drejtorëve të AKP-së, për shkak se ka qenë kërkesë e blerësit i ka shlyer këto ndëshkime financiare, e cila është bërë në bazë të marrëveshjes kontraktuale.

Valon Tolaj, AKP, duke vazhduar me përgjigje, tha se sa i përket inkasimit të ndëshkimeve jemi në një vakuum ligjor në këtë situatë. Fakti që i janë tërhequr aksionet është ndëshkimi më i madh. Mundësia e inkasimit të këtyre ndëshkimeve është shumë e vogël për shkak se ka zgjatur shumë procesi dhe parashkruhen ndëshkimet. Rastet e mos pagesës së qirasë i kemi dërguar në procedurë përmbartuese për inkasim të qerasë. Sa i përket buxhetit të AKP-së, sipas ligjit AKP ka buxhetin 5% të të hyrave nga shitjet, mirëpo për shkak të zvogëlimit të shitjeve rrezikojmë të mos ketë buxhet për operim të AKP-së dhe detyrohemi me kërkua prej Qeverisë dhe Parlamentit. Qiratë e aseteve të mëdha nuk jepen pa garancion bankar. Nuk ka qiramarrës, i cili nuk e ka paguar qiranë, e që nuk është në procedurë përmbartimore. Po ashtu jemi duke i larguar qiramarrësit të cilët nuk e paguajnë qiranë. Lidhur me pyetjen pse nuk ia kemi ndalur mjetet Qeverisë, është se ne me ligj jemi të obliguar të ia japim Qeverisë mjetet. Qeveria i ka borxh për shpronësimet e bëra, por nuk e ka bërë vlerësimin e aseteve të shpronësuara. Ky borxh kërkohet vetëm për të kompensuar 20%-shin për punëtorët e aseteve të shpronësuara. Anulimet e shitjeve bëhen kur ofertat janë me vlerë të ultë, në mënyrë që herën tjetër të shitjes të ketë oferta me vlerë më të lartë. Lidhur me MIM Golesh po bëhet një studim fizibiliteti që të shihet mundësia e përmirësimit të MIM Golesh që të jetë në gjendje të bëjë përpunimin e mineraleve. Studimi i fizibilitetit pritet të përfundojë në shtator. Çështja e privatizimit të Grand Hotel do të trajtohet me ligjin për investime strategjike. Lidhur me Fabrikën e Baterive në Pejë, çështja është në procedurë hetimore nga prokuroria dhe nuk mund të japim më shumë detaje për momentin. AKP-ja e ka një Exit strategji përmbyllëse, por kjo varet nga institucionet tjera e sidomos nga efikasiteti i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Janë rreth 30 mijë lëndë në procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Janë rreth 2 mijë asete të pa shitura, dhe procesi i privatizimit pritet të zgjasë edhe 7 deri 10 vjet. Sa i përket listës së aseteve pa kontratë, theksojmë se asete pa kontratë me sektorin privat nuk ka. Asete në shfrytëzim pa kontratë kryesisht janë nga institucionet qendrore dhe lokale (p.sh. Komuna e Prizrenit), por edhe ndërkombëtare (p.sh. Kampi Bonsteil-i, Kampi Film City). Të gjitha asetet që janë të

identifikuara mbikëqyrën nga AKP. Ka raste kur asetet kanë probleme kadastrale, i është ndryshuar pronësia, por për të gjitha këto asete ne bëjmë ankesë në organet kompetente. AKP ballafaqohet edhe me vendime gjyqësore të viteve të 90-jeta. Këto raste diskutohen dhe trajtohen nga AKP-ja. Kuvendi do të duhej të miratonte një ligj që vendimet diskriminuese të viteve 90-jeta të i shpallë të pavlefshme. Asetet që janë në kadastër në emër të ndërmarrjeve shoqërore nuk janë të uzurpuara nga privatët.

Glauk Konjufca pyeti se a keni të drejtë dhe mundësi me dhënë mendim për vendimin e Qeverisë për ndalimin e privatizimit të aseteve në disa komuna?

Bajram Zejnullahu, AKP, tha se ka raste të tjetërsimit në mënyrë të paligjshme edhe pas vendimit të Qeverisë.

Muharrem Nitaj pyeti se cilat janë kompetencat e AKP-së për trajtimin e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore që janë jashtë Kosovës, si dhe pronat që janë jashtë Kosovës që kanë qenë pronë e Kosovës? A keni komunikim me këto vende ku ndërmarrjet shoqërore dhe Kosova kanë prona dhe çka ka ndodh me ato prona?

Valon Tolaj, AKP, sqaroi se vendimi i Qeverisë ka të bëjë me disa Komuna të caktuara që kanë kërkuar me shpronësuar. Ka prona që janë kërkuar nga Komuna për shpronësim pasi është shitur prona dhe janë paguar mjetet dhe ka mbetur vetëm nënshkrimi formal i shitjes. Probleme në veri kemi shumë, sepse shitja e aseteve në veri lidhet me dokumentacione që nxirren nëpër Komuna, ndërsa Komunitat në veri nuk bashkëpunojnë me AKP-në. “Trepça” ka kaluar komplet te “Trepça Sh. A.”. “Trepça” e mbetur nuk ka asete me vlerë. Asetet me vlerë kanë kaluar në “Trepça Sh.A.” Asetet jashtë vendit janë tepër të komplikuar. Fokusin e kemi më tepër në Mal të Zi. Kemi procese gjyqësore në Mal të Zi. Kemi lëndë të aseteve të identifikuara por nuk kemi dokumentacione. Aty ku kemi mirëkuptim marrim dokumentacione, sidomos Mali i Zi është shumë bashkëpunues. Sa i përket kornizës ligjore, jemi në fazën e propozimit për ndryshim të ligjit të AKP-së lidhur me buxhetin që është i specifikuar në 5% për AKP-në. Pra, kërkesa është që me ligj të rritet buxheti i AKP-së për të ushtruar veprimtarinë, çështje tjera të pengesave ligjore nuk kemi.

Pas diskutimeve, komisioni, me 5 (pesë) vota “për” dhe 1 (një) “kundër”, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP për vitin 2018

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

a) Kryetarja njoftoi deputetët se KDI ka propozuar që ne, si Komision, me vizituar ARKEP-in, meqenëse muaji qershor i vitit të kaluar ka qenë si afat i fundit për transferimin e kodit telefonik të Kosovës në “+383”. Prandaj ta caktojmë bashkërisht datën kur mund të shkojmë si komision.

Komisioni vendosi që vizita mbikëqyrëse në ARKEP të realizohet të hënën më 17.6.2019.

b) Lutfi Zharku theksoi se Projektligji për plotësim ndryshim të ligjit për automjete që e kemi në procedurë në lexim dytë, e kam një amendament aty, por jam i interesuar me riformuluar amendamentin, nuk e di a mund ta kthejmë në lexim të tretë apo vetëm ta paraqesë në Kuvend.

Muharrem Nitaj, si kryesues i grupit të punës, theksoi se në seancë plenare është ndryshuar projektligji në thelb, dhe nuk mund të kalojë pa u rikthyer edhe njëherë në Komision për me u harmonizuar edhe me u specifiku saktë se cilat janë amendamentet. Komisioni ka votuar diçka tjetër, deputeti Mërgim Lushtaku ka propozuar diçka tjetër në seancë plenare.

Komisioni vendosi që kryetarja e komisionit të kërkojë në seancë nga Kuvendi të procedojë projektligjin për lexim të tretë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA